



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA026

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatës Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shkurt 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Katërt për Pjesëmarrjen e Viktimave

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësve të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara:
Jelena Cakiq
Gregori Taunsend

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave:
Tadeja Novinc

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”, përkatësisht),¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e bërë nga mbrojtësja e viktimave parashtruese të kërkesave 23/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06 (bashkërisht, “Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara”)² – kërkesat e të cilëve për pjesëmarrje në proces u shpallën të papranueshme më 12 dhjetor 2022 në “Versionin e Redaktuar Publik të Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” (“Vendimi i Kundërshtuar”)³ – përmes të së cilës ajo kërkon shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për parashtrimin e apelit kundër Vendimit të Kundërshtuar nga 6.000 fjalë në 15.000 fjalë (“Kërkesa”).⁴

1. Paneli i Gjykatës së Apelit kujton se, më 7 shkurt 2023, miratoi Kërkesën e bërë nga Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara me anë të së cilës kërkonte shtyrjen e afatit për dorëzimin e apelit kundër Vendimit të Kundërshtuar, dhe urdhëroi që çdo apel i tillë të dorëzohej deri më 15 shkurt 2023 ose shtatë ditë pas njoftimit të të gjithë Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara për Vendimin e Kundërshtuar, në cilëndo datë të mëvonshme.⁵

¹ IA026/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 shkurt 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 7 janar 2023).

² F01182, Njoftimi i Caktimit të Dy Mbrojtësve të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, 28 dhjetor 2022; F01182/A02, Shtojca 2 e Njoftimit të Caktimit të Dy Mbrojtësve për Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara, 28 dhjetor 2022 (konfidencial dhe *ex parte*).

³ F01152/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 14 dhjetor 2022 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 dhjetor 2022) (“Vendim i Kundërshtuar”).

⁴ IA026/F00005/RED, Kërkesë e Redaktuar Publike e Mbrojtësit të Viktimave për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 10 shkurt 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 10 shkurt 2023) (“Kërkesa”).

⁵ IA026/F00004, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 7 shkurt 2023 (“Vendimi mbi Kërkesën për Zgjatje Afati”).

2. Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e Kërkesës dhe se Mbrojtjes apo Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk u shkaktohet asnjë dëm duke pasur parasysh: (i) numrin e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara; dhe (ii) faktin se i gjithë informacioni përkatës nuk ishte i përfshirë në kërkesat fillestare të tyre të cilat sipas Kërkesës shpiten në refuzimin e të drejtës së tyre për të marrë pjesë në proces.⁶

3. Paneli vëren se neni 46(2) i Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”) përcakton se apelet e ndërmjetme nuk duhet të jenë më shumë se 6.000 fjalë.⁷ Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton se në rrethana të posaçme, një pjesëmarrës mund t’i kërkojë leje Panelit mjaftueshmërisht në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve duke dhënë arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të posaçme.

4. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të Kërkesës, Paneli vëren se ajo është dorëzuar vetëm tri ditë pune përpara afatit më të hershëm të mundshëm të 15 shkurtit 2023 për dorëzimin e apelit kundër Vendimit të Kundërshtuar.⁸ Megjithatë, Paneli mendon se Kërkesa është dorëzuar mjaftueshmërisht në kohë, duke pasur parasysh afatin e zbatueshëm në këto procedura apeli dhe se do të shqyrtojë themelësinë e tij.

5. Duke parë kushtet e tjera të nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës, Paneli konstaton se Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara nuk arriti të vërtetojë në parashtrimin e saj se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e shtimit të numrit të lejuar të fjalëve, i cili përbën më shumë se dyfishin e numrit të lejuar të fjalëve të përdorura. Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara i referohet “numrit të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara dhe faktit që ata nuk kanë përfshirë të

⁶ Kërkesa, para 2.

⁷ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

⁸ Shih më lart, para. 1.

gjithë informatat përkatëse [sic] në kërkesat e tyre”,⁹ pa dhënë ndonjë shpjegim tjetër për mënyrën se si këta faktorë përlligjin – veç e veç apo së bashku – tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve.

6. Për më tepër, duke qenë se Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara argumenton se nevoja për paraqitjen e informacionit shtesë që mungonte në kërkesat fillestare të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara përbën arsye të vlefshme për miratimin e Kërkesës, Paneli kujton se apeli i ndërmjetëm nuk është shqyrtim nga e para (*de novo*) i një vendimi të kundërshtuar dhe se është në fakt masë korrigjuese, fushëveprimi i së cilës përcaktohet nga kuadri i procesit përkatës para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁰ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk shqyrton informacion apo material që nuk është paraqitur para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në kohën e lëshimit të Vendimit të Kundërshtuar. Paneli kujton gjithashtu se argumentet e paraqitura për herë të parë në apel duhen hedhur poshtë menjëherë.¹¹ Për këtë arsye, Paneli konstaton se trajtimi në apelin e ardhshëm i informacionit që mungon në Kërkesat e Refuzuara të Parashtruesve nuk përbën arsye të vlefshme për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve.

7. Rrjedhimisht Paneli konstaton se Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara nuk arrin të tregojë se si, në rastin konkret, ekzistojnë rrethana të posaçme për përlligjen e një parashtrimi të protokolluar kaq të gjatë.¹²

⁹ Kërkesa, para 2.

¹⁰ Neni 46(1)-(2) i Ligjit; KSC-BS-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 5-10, 19 (ku Paneli i Apelit konstatoi se neni 46 i Ligjit zbatohet *mutatis mutandis* për apelet e ndërmjetme dhe se procedurat para Panelit të Apelit kanë natyrë korrigjuese); ICC, *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-202, Decision on the “Filing of Updated Investigation Report by the Government of Kenya in the Appeal against the Pre-Trial Chamber’s Decision mbi Admissibility”, 28 July 2011, para. 12.

¹¹ KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021, para. 15.

¹² KSC-BC-2020-04, IA006/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Shalës për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, 8 shkurt 2023 (“Vendimi i Apelit në çështjen *Shala* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”), para. 4; KSC-CA-2022-01, F00063, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e

8. Së fundi, Paneli kujton se, në bazë të nenit 36(2) të Udhëzuesit të Punës, vendimi për mocionet për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të merret pa u dhënë palëve mundësinë të dëgjohen.¹³ Duke pasur parasysh rëndësinë e garantimit të procedurave të shpejta në apel, afatin e afërm të dorëzimit të apelit kundër Vendimit të Kundërshtuar, dhe meqenëse palëve nuk do t'u shkaktohet asnjë dëm, Paneli mendon se është në interes të drejtësisë që vendimi për Kërkesën të merret menjëherë.

9. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

E RRËZON Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
kryegjykatëse

E mërkurë, 15 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë

Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjet Kundërpërgjigjëse, 12 tetor 2022 ("Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve"), para. 6.

¹³ Vendimi i Apelit në çështjen *Shala* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 6; Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 8.